

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**G&E INVESTMENT**

**Neni 1**

**Emri**

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është G&E INVESTMENT Shpk, që këtu e më poshtë do të quhet "Shoqëria".

**Neni 2**

**Themelimi**

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe këtë Akt Themelimi.

**Neni 3**

**Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Vaso Pasha, Godina nr.2, Kati 2, Tiranë.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 4**

**Ortakët e Shoqërisë**

4.1 Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë:

- (a) **Gledis Çela**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 21.09.1986, i pajisur me pasaporte nr. BC0341133, me adresë: Rr. Vaso Pasha, godina përballë bar Tribeca, Kati 2, Tiranë, zotërues i 1 (një) kuote kundrejt kontributit prej 50.000 lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- (b) **Endrit Shabani**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 24.01.1988, i pajisur me letërnjoftim nr. 034041121, me adresë: Rr. Vaso Pasha, godina përballë bar Tribeca, Kati 2, Tiranë, zotërues i 1 (një) kuote kundrejt kontributit prej 50.000 lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.000 lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota, në raport me kontributin e dhënë nga secili prej ortakëve.

5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë sipas neni 4 të këtij Akti Themelimi.

5.3 Kuotat, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji.

## **Neni 6 Objekti**

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:

- Ndërmjetësim, investim, ndërtim objekt eksport dhe tregtim i materialeve të ndryshme.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 7 Kohëzgjatja**

7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 8 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

8.1 Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar, vetem në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

## **Neni 9 Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- Gledis Çela, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 21.09.1986, i pajisur me pasaporte nr. BC0341133 me adresë: Rr. Vaso Pasha, godina përballë bar Tribeca, Kati 2, Tiranë.

9.2 Administratori emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratori shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

## **Neni 10**




### Ligji i Zbatueshëm

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.  
10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar, sot më datë 03.02.2022

### Ortakët themelues

Gledis ÇELA



Endrit SHABANI

